



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



01-136

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-31672/22 dt. 14.02.2022, të pronareve Bejtulla Purova, Agim Jashari dhe Miftar Miftari nga Prishtina, dhe investitorit “Partner & Dervisholli” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Ekrem Qarolli nga Prishtinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, ndërtuar në kuadër të Planit Rregullues “Kalabria”, në rr. “Fatime Sokoli” dhe “Nebih Gashi” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 11.03.2022, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET Bejtulla Purova, Agim Jashari dhe Miftar Miftari nga Prishtina, dhe investitorit “Partner & Dervisholli” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Ekrem Qarolli nga Prishtinë, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-31672/22 dt. 14.02.2022, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet 2B+P+10, e ndërtuar sipas Aktvendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-33132/19 dt. 26.04.2019, në parcelen kadastrale nr. 7600-7 të evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914059-07600-7, ZK Prishtinë, konkretisht në kuadër të bllokut urban “B1”, të tërsisë urbane “B”, të Planit Rregullues “Kalabria”, në Prishtinë.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, të ndërtuara në rrugën “Fatime Sokoli” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 21, 23, 25, 27, 29, 31, 33, 35, 37 dhe “Nebih Gashi” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 70, 72, 74, në Prishtinë, do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

VI. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

V. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronareve Bejtulla Purova, Agim Jashari dhe Miftar Miftari nga Prishtina, me investitor “Partner & Dervisholli” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Ekrem Qarolli nga Prishtinë, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-31672/22 dt. 14.02.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet 2B+P+10, e ndërtuar në kuadër bllokut urban “B1”, të tërsisë urbane “B”, të Planit Rregullues “Kalabria”, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parceles kadastrale nr. 7600-7 të evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914059-07600-7, ZK Prishtinë, ndërtuar sipas Aktvendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-33132/19

dt. 26.04.2019, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr.391/02-79781/21, të dt. 02.02.2022 ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuessit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Bajram Sinani; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Arsim Rapuca; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Lirie Beka; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Valbonë Beka; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Gazmend Krasniqi; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Edona Sheqerolli me nr. të licensës 101;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA-ja.

I dorëzohet: Kërkuessit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-31672/22 DT. 11.03.2022



Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu
B. Vllasaliu

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Mimoza Berisha Prestreshi

Handwritten signature of Mimoza Berisha Prestreshi in blue ink.

Drejtori,
Arber Sadiki



